

EC  
MA NDRYSHE

JANAR 2021

# CILËSIA E AJRIT NË PRIZREN



EC Ma Ndryshe

# CILËSIA E AJRIT NË PRIZREN

Autor dhe botues: EC Ma ndryshe

Rr. Fehmi Lladrovci 94, Prizren &  
Bulevardi Nënë Tereza 30B H1 Nr.5, Prishtinë  
[www.ecmandryshe.org](http://www.ecmandryshe.org) [info@ecmandryshe.org](mailto:info@ecmandryshe.org)  
029 222 771 & 038 224 967

Hulumtimi “Cilësia e ajrit në Prizren” është realizuar nga EC Ma Ndryshe, i cili mbështetet nga Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar, (Sida) përmes Programit të saj “Human Rightivism” që implementohet nga Community Development Fund – CDF.

Përmbajtja dhe qëndrimet e paraqitura këtu nuk përfaqësojnë qëndrimin zyrtarë të donatorëve.

Janar, 2021



## Cilësia e ajrit dhe niveli i shqetësimit të qytetarëve të Prizrenit

Cilësia e dobët e ajrit është një rrezik i madh shëndetësor, duke shkaktuar sëmundje të ndryshme. Sipas raportit nga Agjencia Evropiane e Mjedisit, më shumë se 500,000 njerëz vdiqën në Evropë në 2015 për shkak të ndotjes së ajrit. Ndotja e ajrit gjithashtu ka ndikime në mjedis, duke ndikuar në cilësinë e ujit të ëmbël, tokës dhe ekosistemeve. Gjithashtu mund të dëmtojë materialet dhe ndërtesat, dhe disa ndotës të ajrit sillen si gazra serë që shkaktojnë ndryshime klimatike<sup>1</sup>.

Ndotja e ajrit dëmton gjithashtu bimësinë dhe ekosistemet. Ajo çon në disa ndikime të rëndësishme mjedisore, të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në bimësi dhe faunë, si dhe në cilësinë e ujit dhe tokës. Ndotësit më të dëmshëm të ajrit për sa i përket dëmtimit të ekosistemeve janë  $O_3$ , amoniaku dhe oksidet e azotit (NOX). Ndikimi i ndotjes së ajrit në materialet e trashëgimisë kulturore është një shqetësim serioz, sepse mund të çojë në humbjen e pjesëve të historisë dhe kulturës evropiane. Dëmtimi përfshin korrozionin (të shkaktuar nga përbërësit acidifikues), biodegradimin dhe ndotjen (të shkaktuar nga grimcat), dhe tretjen e gurëve dhe mineraleve në sipërfaqen e tokës dhe zbehjen e ngjyrës (shkaktuar nga  $O_3$ )<sup>2</sup>.

Sipas raportit për Kosovën të Komisionit Evropian për vitin 2020, në Kosovë cilësia e ajrit vazhdon të përbëjë një kërcënim të madh për shëndetin. Ndotja e pakontrolluar, veçanërisht nga termocentralet e vjetruara, ngrohja shtëpiake, trafiku, emetimet industriale dhe djegia e mbeturinave dhe materialeve të tjera toksike, kërkojnë masa urgjente.

<sup>1</sup> [https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/MEMO\\_13\\_1169](https://ec.europa.eu/commission/presscorner/detail/en/MEMO_13_1169)

<sup>2</sup> <https://www.eea.europa.eu/publications/air-quality-in-europe-2019>

Përdorimi i drurit për ngrohje është njëri nga kontribuesit më të mëdhenj të ndotjes së ajrit dhe burimi kryesor i pluhurit grimcor. Komuna e Prizrenit nuk posedon sistem të ngrohjes qendrore, prandaj shumica dërmuese e banorëve shfrytëzon drurin si burim të vetëm për ngrohje duke shkaktuar ndotje të konsiderueshme të ajrit, në veçanti gjatë periudhës së dimrit. Nga gjithsej 28.682 objekte banimi, 26.070 shfrytëzojnë drurin për ngrohje, ndërsa 2061 banorë përdorin energjinë elektrike. Në masë më të vogël përdoret thëngjilli, nafta dhe gazi natyror. Në Kosovë nga ndotja e ajrit llogaritet se vdesin rreth 760 njerëz në vit prej të cilëve 90% janë nga sëmundjet kardiovaskulare dhe sëmundjet e arterieve të zemrës.

Transporti është përgjegjës për më shumë se dy të tretat e emetimit të oksideve të azotit (NO<sub>x</sub>) dhe me përrreth 10% të emetimit të përgjithshëm të ndotësve tjerë. Transporti rrugor në veçanti vazhdon të përbëjë pjesën më të konsiderueshme të ndotësve kryesorë të ajrit (me përjashtim të oksideve të sulfurit). Në Kosovë emetimet e ndotjes nga automjetet janë rritur përgjatë viteve si pasojë e përdorimit të veturave të vjetra dhe përdorimit të tyre si mjeti kryesor për transport<sup>3</sup>.

Kosovarët dhe popujt që jetojnë në Ballkan dhe në Evropën Lindore zakonisht thithin me frymëmarrje më shumë grimca toksike sesa fqinjët e tyre në Evropën Perëndimore. Kjo është për shkak të më pak politikave për reduktim të ndotjes së ajrit dhe ngrohjes dhe gatimit duke përdorur karburant të ngurtë (domethënë shumë më shumë ngrohëse të

<sup>3</sup> [https://ecmandryshe.org/repository/docs/200823152611\\_Gjendja\\_mjedisore\\_ne\\_Prizren1.pdf](https://ecmandryshe.org/repository/docs/200823152611_Gjendja_mjedisore_ne_Prizren1.pdf)




drurit dhe qymyrit nëpër banesa) në shtetet e Evropës Lindore dhe të Ballkanit për dallim me pjesën tjetër të Evropës. Cilësia e ajrit të ambientit vlerësohet jo vetëm nga koncentrimi i një ndotësi, por edhe për sa herë tejkalohe vlera kufitare për atë ndotës. Sipas standardeve të cilësisë së ajrit në Kosovë, koncentrimi 24-orësh ose mesatar ditor i PM 10 nuk duhet të tejkalohe më shumë se 35 herë në një vit kalendarik<sup>4</sup>.

EC Ma Ndryshe ka realizuar këtë hulumim në formë të anketave me qytetarë, hulumtim ky i cili synon të kuptojë se si e vlerësojnë qytetarët cilësinë e ajrit në qytetin e Prizrenit, të identifikojë burimet kryesore të ndotjes sipas qytetarëve dhe të kuptojë se sa janë të shqetësuar këta të fundit për këtë situatë. Në këtë hulumtim kanë qenë të përfshirë 104 persona, nga ta 46 burra dhe 58 gra. Anketa është zhvilluar me qytetarë të lagjeve: Arbanë, Bazhdërhanë, Bajram Curr, Dardani, Hoçamahallë, Jeni Mahallë, Jeta e Re, Kurillë, Lakuriq, L.e Spitalit, L.e Trimave, Ortakoll, Qendër - Zona Historike, Ralin, Terzimahallë, Tabakhanë, Tusuz.


<sup>4</sup> <http://documents1.worldbank.org/curated/en/927281579895920533/pdf/Air-Pollution-Management-in-Kosovo.pdf>

## 1. Si e vlerësoni cilësinë e ajrit në qytetin tuaj tani krahasuar me vitin e kaluar?



56.7% e të anketuarve janë shprehur se cilësia e ajrit në qytetin e tyre është në nivel të njëjtë sikur vitin e kaluar. 22.1% mendojnë se cilësia e ajrit është më mirë se vitin e kaluar (vlerësuar njëjtë nga të gjitha grupmoshat e anketuara 18vjeç-65+), ndërsa ndryshe nga këta mendojnë 21.2% e qytetarëve duke e vlerësuar cilësinë e ajrit si më keq se në vitin e kaluar. Mendim të njëjtë ndajnë edhe burrat edhe gratë e anketuara duke u përgjigjur në përqindje më të madhe në opsionin se cilësia e ajrit në qytet është ngjashëm sikur vitin e kaluar.

## 2. Cilat nga të poshtëshënuarat mendoni se janë shkaktarët kryesor të ndotjes së ajrit në qytetin tuaj?




Ndotësit e ajrit janë të shumtë, duke filluar nga automjetet motorike, ngrohjet shtëpiake, djegia e mbeturinave dhe të tjera. Qytetarët e Prizrenit, respektivisht 26.4% e tyre u shprehën se kontribues më të mëdhenj të ndotjes së ajrit janë automjetet motorike. 18.9% e tyre mendojnë se shkaktar kryesor i ndotjes së ajrit është djegia e mbeturinave, 18.2% vlerësojnë që ngrohjet shtëpiake janë shkaktarë të ndotjes, 11.1% ndërtimi, 9.3% burimet industriale/objektet e prodhimit, 7.5% tymi i cigareve, 6.8% termocentralet dhe 1.8% përdorimi në rritje i kondicionerit.

Si nga burrat, ashtu edhe nga gratë, por edhe vlerësuar nga grupmoshat e personave të anketuar, opsioni me përqindje më të lartë qëndron automjetet motorike si ndotës më të mëdhenj në vendon tonë.




### 3. Cilin nga mjetet e poshtëshënuara të transportit ju i përdorni gjatë ditës?



Sipas anketës së realizuar me qytetarët e Prizrenit, nënkuptohet që makina është mjeti transportues më i përdorur nga ata. 44.2% e të anketuarve janë përgjigjur që gjatë ditës përdorin makinë si mjet transportues. 28% e tyre kanë deklaruar që nuk përdorin mjet transporti por preferojnë ecjen në këmbë, 12.5% e qytetarëve përdorin autobusin, 10.6% përdorin biçikletën dhe 3.8% përdorin taksi si mjet transporti. Shikuar sipas gjinisë vlerësohet se 58.7% e të anketuarve burra e përdorin makinën ndërsa 39.7% e grave preferojnë ecjen në këmbë. Ndërsa shikuar sipas moshës, derisa sa kategoritë e tjera e përdorin makinën për transport, grupmosha 18-24 vjeç nuk përdorin ndonjë mjet transportues, por preferojnë të ecin në këmbë.


### 4. Sa po ndikon ndotja e ajrit tek ju?



Për shumicën e qytetarëve ndotja e ajrit ndikon shumë. Në pyetjen e parashtruar, 59.6% e qytetarëve janë përgjigjur se ndotja e ajrit ndikon shumë tek ta, 38.5% e tyre janë përgjigjur se ndikon pak kurse në një përqindje më të vogël (1.9%) qytetarët janë përgjigjur se ndotja e ajrit nuk ndikon aspak tek ata. 50% e burrave dhe 67.2% e grave vlerësojnë se ndotja e ajrit ndikon shumë tek ta, deri sa një përqindje më e vogël janë shprehur se nuk ndikon ndotja e ajrit (2.2% e burrave dhe 1.7% e grave). Ndërsa shikuar sipas moshës të gjitha kategoritë shprehen se ndikon shumë më përjashtim të kategorisë 55-64 vjeç të cilët e vlerësojnë se ndotja tek ta ndikon më pak.




## 5. Në cilat nga mënyrat e poshtëshënuara ndikon më shumë ndotja e ajrit tek ju?




Nga 104 të anketuar, 30.4% janë shprehur se ndotja e ajrit shkakton vështirësi në frymëmarrje, 21% janë shprehur se shkakton iritim në sy/hundë/fyt, 14.7% e qytetarëve janë shprehur se kjo ndotje përcillet me shqetësim për gjendjen e mjedisit. Në përqindje të njëjtë (10.3%) qytetarët janë shprehur se për shkak të ndotjes detyrohen t'i limitojnë aktivitetet në natyrë dhe kanë ndjenjë depresioni, 8.5% e qytetarëve kanë probleme me lëkurë për shkak të ndotjes dhe 4.9% kanë incidenca të frymëmarrjes. Për të dy gjinitë problem kryesor që shoqëron cilësia e ajrit, është vështirësitë në frymëmarrje. Ndërsa sipas moshës, e sidomos sipas grupmoshës 18-24 vjeç (26.3%) është pohuar se në përqindje të afërt me vështirësi në frymëmarrje, ata kanë edhe iritime në sy, hundë dhe fyt, kjo për shkak të cilësisë së ajrit në vendin tonë.

## 6. Ju lutemi shprehuni sa pajtoheni me thëniet e mëposhtme.







## 1) Mbikëqyrja e vazhdueshme e filtrave nga termocentralet dhe fabrikat do ta ulte nivelin e ndotjes së ajrit




## 2) Institucionet përgjegjëse duhet të bëjnë më shumë për të promovuar dhe inkurajuar një mjedis më të mirë




## 3) Policia duhet të ndalojë dhe kontrollojë më shpesh emetimet e makinave




## 4) Përmirësimi i gjendjes së mjedisit është përgjegjësi e çdo qytetari




## 5) Kompanitë ndotëse duhet të gjobiten



## 6) Ndotja është jashtë kontrollit tim dhe nuk mund të bëj asgjë për ta ndryshuar këtë gjendje



## 7) Unë nuk e shoh ndotjen si problem




Në kuadër të kësaj ankete janë mbledhur disa mendime se çka vlerësojnë qytetarët si masa preventive për ndotje të mjedisit.


78.2% e qytetarëve pajtohen plotësisht se “Mbikëqyrja e vazhdueshme e filtrave nga termocentralet dhe fabrikat do ta ulte nivelin e ndotjes së ajrit”, 77.5% pajtohen plotësisht se “Institucionet përgjegjëse duhet të bëjnë më shumë për të promovuar dhe inkurajuar një mjedis më të mirë”, 51% pajtohen plotësisht se “Policia duhet të ndalojë dhe kontrollojë më shpesh emetimet e makinave”, 85.3% pajtohen plotësisht se “Përmirësimi i gjendjes së mjedisit është përgjegjësi e çdo qytetari”, 69% e qytetarëve pajtohen plotësisht se “Kompanitë ndotëse duhet të gjobiten”, 56% e qytetarëve nuk pajtohen se “Ndotja është jashtë kontrollit të tyre dhe nuk mund të bëjnë asgjë për ta ndryshuar këtë gjendje” kurse 16% pajtohen plotësisht. Vetëm 4.9% e qytetarëve nuk e shohin ndotjen si problem, ndërsa 81% e tyre nuk pajtohen me këtë nocion.




## 7. Ju lutem paraqitni nivelin e shqetësimit tuaj për efektet e këtyre çështjeve mjedisore në shëndetin tuaj personal? Renditni nivelin tuaj të shqetësimit me: 1 - shqetësimin më i ulët; 5 - shqetësim më i lartë:




### 1) Ndotja e ajrit




### 2) Ndotja e ujit të pijshëm




### 3) Mbeturinat



### 4) Ngrohja globale dhe ndryshimet klimatike



### 5) Humbja e sipërfaqeve të gjelbërta në qytet





Ndotja e ajrit, ndotja e ujit të pijshëm, mbeturinat, ngrohja globale e ndryshimet klimatike dhe humbja e hapësirave të gjelbërta në qytet janë problemet mjedisore të cilat janë adresuar në këtë anketë e që është synuar të mirret një vlerësim rreth shqetësimit që e kanë qytetarët për këto probleme.


49% e qytetarëve e vlerësojnë ndotjen e ajrit si shqetësim të lartë ndërsa 2.9% e vlerësojnë si shqetësim të ulët. Shikuar sipas gjinisë, 41.3% e burrave dhe 55.2% e grave e shohin si shqetësim të lartë ndotjen e ajrit në vendin tonë. Ndërsa shikuar sipas moshës më të shqetësuar për gjendjen e ajrit janë deklaruar grupmosha 45-54 vjeç, me 76.9%.

55.4% e qytetarëve janë shumë të shqetësuar rreth cilësisë së ujit të pijshëm, derisa 44.2% e shohin si shqetësim menaxhimin e mbeturinave në qytetin e Prizrenit. Ndrohja globale e ndryshimet klimatike janë një problem tjetër mjedisor që sjell shqetësim të lartë tek qytetarët (35.6%).


49% e qytetarëve të Prizrenit janë të shqetësuar në nivel të lartë për humbjen e sipërfaqeve të gjelbërta në qytet, deri sa një përqindje më e vogël e tyre ndihen më pak të shqetësuar për këtë dukuri.

Shikuar nga mesatarja e përgjithshme e përgjigjeve të fituara nga qytetarët, nënkuptohet që humbja e sipërfaqeve të gjelbërta në qytetin e Prizrenit, është problem mjedisor për të cilin qytetarët janë më së shumti të shqetësuar me një përqindje 4.21% duke lënë pas ndotjen ujit të pijshëm me përqindje 4.13%.


## 8. Sipas juve, sa i ka përmbushur Komuna funksionet dhe përgjegjësitë e veta lidhur me gjendjen e ajrit dhe mjedisit? Vendosni ✓ në kolonën që ju pajtoheni:




## 1) Hapësirat e gjelbra dhe rekreative



## 2) Transporti urban




## 3) Ndërtimet pa leje







#### 4) Pastrimi dhe riciklimi i mbeturinave



#### 5) Asfaltimi i rrugëve dhe mbjellja e pemëve përgjatë tyre



#### 6) Ndërgjegjësimi qytetar për mjedisin




Sipas qytetarëve të Prizrenit, Komuna ka përmbushur dobët funksionet e veta lidhur me hapësirat e gjelbërta dhe rekreative (37.9%) dhe me transport urban (38.2%). Shikuar sipas moshës, si më të pakënaqur janë shprehur grupmosha 18-24 vjeç. Ndërsa sa i përket ndërtimeve pa leje (48%) dhe pastrimit të mbeturinave (32%), qytetarët e vlerësojnë si shumë të dobët përmbushjen e përgjegjësive të Komunës. Për këto probleme mjedisore më të pakënaqur janë shprehur grupmosha 55-65+.

Asfaltimin e rrugëve dhe mbjelljen e pemëve përgjatë tyre e vlerësojnë poashtu si të dobët me një përqindje 30.4%. Vlerësuar sipas gjinisë së të anketuarve, mund të konkludohet se burrat janë më pak të kënaqur me përmbushjen e përgjegjësive komunale krahasuar me gratë.

Në anën tjetër ndërgjegjësimi qytetar për mjedisin vlerësohet si dobët i përmbushur me një përqindje 37.9%.

## 9. Publiku duhet të ketë qasje në informatat e përditësuara për përqëndrimin e materieve ndotëse në ajër, të cilat monitorohen përmes sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit që rregullohet me Ligjin Nr. 03/L-160



Në pyetjen e parashtruar rreth kornizës ligjore për qasje në informata për përqëndrimin e materieve ndotëse në ajër, bazuar në përgjigjet e qytetarëve mund të konkludohet se 44.2% e qytetarëve nuk kanë njohuri për këtë ligj, derisa ndryshe nga ta një përqindje më e vogël kanë njohuri për këtë ligj (17.3%). Kurse 38.5% e qytetarëve nuk kanë njohuri për asnjë nga ligjet e ndotjes së ajrit në përgjithësi.

Shikuar sipas gjinisë për kornizën ligjore në përgjithësi pak më pak të informuara janë gratë (39.7%) krahasuar me burrat (37%). Ndërsa shikuar sipas moshës, më pak të informuar për ligjet janë grupmosha mbi 65 vjeç.



# REKOMANDIME

**1.** Bazuar në përgjigjet e qytetarëve të Prizrenit në lidhje me cilësinë e ajrit në vendin e tyre, mund të konkludohet që cilësia e ajrit nuk është përmirësuar dhe qytetarët ende janë të pakënaqur dhe të rrezikuar. Prandaj institucionet rekomandohen që të rrisin zbatimin e masave konkrete në drejtim të përmirësimit të cilësisë së ajrit. Autoritetet lokale duhet të informojnë publikun në lidhje me përqendrimet lokale të ndotësve të ajrit, efektet e mundshme në shëndet, dhe veprimin që mundëson minimizimin e rreziqeve shëndetësore.



**2.** Përdorimi i pakontrolluar dhe i pakoordinuar i burimeve mjedisore rezultojnë në shumë probleme mjedisore. Sidomos në vendbanimet urbane zhvillimi infrastrukturor dhe aktiviteti urban kanë ushtruar presion të madh. Për ta reduktuar ndotjen, institucionet rekomandohen që t'i targetojnë burimet kryesore duke trajtuar secilin burim të ndotjes me një strategji të veçantë përmes marrjes së praktikave ndërkombëtare. Për reduktimin e ndotjes nga automjetet qeveria duhet të promovojë përdorimin e makinave hibride dhe atyre që shkaktojnë ndotje të ulët përmes subvencionimit të qytetarëve për blerjen e tyre dhe të largojë taksën ekologjike me të cilën i ngarkon momentalisht pronarët e këtyre automjeteve ekologjike. Të respektohen standardet e ndërtimit dhe të lihet hapësirë e mjaftueshme e gjelbër për banorët përreth në mënyrë që të ketë hapësira gjelbëruese që do të reduktonin ndotjen dhe të promovohet ngrohje ekologjike e ndërtesave.



**3.** Makinat kanë dalur si mjeti kryesor dhe më i zakonshëm i transportit nga qytetarët dhe njëkohësisht rezultatet tregojnë se makinat janë shkaktarët kryesor të ndotjes së ajrit. Rekomandohen institucionet përkatëse që të promovojnë përdorimin e transportit publik, përmes shtimit të linjave, respektimit të orarit dhe shtimit të lidhjeve mes lokacioneve në mënyrë që qytetarët ta shtojnë përdorimin e transportit urban dhe të reduktojnë përdorimin e veturave.



# REKOMANDIME



**4.** Duke e marrë parasysh që shumica janë përgjigjur që ndotja e ajrit po ndikon shumë në shëndetin e tyre atëherë institucionet rekomandohet që të marrin masa për përmirësim të cilësisë. Në anën tjetër qytetarët rekomandohet që të marrin masat personale për tu mbrojtur nga ndotësit sidomos gjatë orëve të vona kur shtohet niveli dioksidit dhe monoksidit të karbonit nga ngrohjet shtëpiake.



**5.** Ndotja e ajrit është rreziku më i madh mjedisor për vdekjen e hershme, përgjegjës për deri në 5 milion vdekje të parakohshme çdo vit nga sulmet në zemër, goditjet në tru dhe sëmundjet e frymëmarrjes. Edhe njerëzit e shëndetshëm mund të përjetojnë ndikime shëndetësore nga ajri i ndotur duke përfshirë vështirësitë e frymëmarrjes gjatë aktiviteteve në natyrë. Rreziku aktual i efekteve anësore varet nga gjendja shëndetësore aktuale, lloji i ndotësit dhe përqendrimi, dhe gjatësia e ekspozimit të qytetarëve në ajrin e ndotur. Andaj rekomandohen institucionet që të marrin parasysh këto pasoja të shëndetit publik dhe të përparojnë në drejtim të rritjes së cilësisë së ajrit.

**6.** Qytetarët janë pajtuar më së shumti me rekomandimin që mbikëqyrja e vazhdueshme e filtrave nga termocentralet dhe fabrikat do ta ulte nivelin e ndotjes së ajrit, duke qenë se një nga shkaktarët kryesor të ndotjes në Kosovë vjen nga prodhimi i energjisë elektrike përmes djegies së thëngjillit. Institucionet janë rekomanduar nga qytetarët që të bëjnë më shumë për të promovuar dhe inkurajuar një mjedis më të mirë, e po ashtu nga ta është rekomanduar që edhe Policia e Kosovës të ndalojnë dhe kontrollojnë më shpesh emetimet e makinave si dhe kompanitë ndotëse të gjobiten.





# REKOMANDIME

**7.** Qytetarët janë shprehur se si shqetësim kryesor mjedisor që do të ndikonte në shëndetin e tyre është gjendja e ujit duke e konsideruar si faktor kryesor të jetesës dhe duke e parë që rreziku që mund të vie nga gjendja jo e mirë e tij do të sillte pasoja të larta. Mbikëqyrja e vazhdueshme e cilësisë së tij nga ndotësit sidomos gjatë reshjeve të mëdha është esenciale. Hapësirat e gjelbërta përveç që shihen si pjesë esenciale për zhvillimin e një përditshmërie normale nga qytetarët ato edhe shërbejnë si mushkëri të qytetit. Ato përveç një zone rekreative e filtrojnë ajrin nga ndotësit duke e përmirësuar cilësinë e jetesës. Fatkeqësisht qytetarët kanë vlerësuar së hapësirat e gjelbërta janë të mangëta dhe ka nevojë që të rivitalizohen shumë prej tyre dhe të krijohen hapësira të reja që të përmbushen nevojat e tyre. Në anën tjetër mbeturinat mbeten shqetësim tjetër i madh i të anketuarve. Duke qenë se mbeturinat janë ndotësit të cilët po kontaminojnë cdo sferë duke filluar nga uji, ajri dhe toka atëherë qytetarët edhe e kanë konstatuar si brengë të madhe. Andaj, sa më parë që institucionet të nisin aplikimin e parimit 3R, aq më shumë do të përmirësohet gjendja e mjedisit në këtë aspekt.



**8.** Sipas qytetarëve Komuna e Prizrenit ka performuar dobët në përmbushjen e funksioneve dhe përgjegjësi të veta sa i përket krijimit të hapësirave të gjelbërta dhe rekreative. Rekomandohet që Komuna të shtojë numrin e takimeve konsultuese me banorë që të përfshihen kërkesat e tyre sa i përket zonave të gjelbërta. Njëjtë edhe sa i përket transportit urban, jepet vlerësim i dobët. Duhet të ketë numër të shtuar të linjave, lidhjeve dhe të respektohet orari. Ndërtimet pa leje janë vlerësuar me notë të dobët nga qytetarët. Komuna duhet të shtojë inspektimet në teren dhe të aplikojë ligjin përmes mekanizmave të saj duke ndaluar ndërtimet e egra. Pastrimi dhe riciklimi i mbeturinave është vlerësuar poshtu dobët. Duhet një mirëmbajtje më e madhe e hapësirës publike si dhe komuna duhet të fillojë me projekte për riciklim të mbeturinave. Poashtu duhet të reshtojë veprimtaritë e menaxhimit mjedisor me fuqitë dhe funksionet e qeverisjes lokale dhe të institucionalizojë menaxhimin lokal të mjedisit në kontekstin e zhvillimit të qëndrueshëm duke vendosur mekanizma të veçantë pjesëmarrës për përcaktimin e Agjendës 21 për menaxhim të mjedisit.



# REKOMANDIME

**9.** Shumica e qytetarëve janë shprehur se nuk janë në dijeni për Ligjin Nr.03/L-160 (Publiku duhet të ketë qasje në informatat e përditësuara për përqëndrimin e materieve ndotëse në ajër, të cilat monitorohen përmes sistemit të monitorimit të cilësisë së ajrit). Komuna e Prizrenit në kuadër të aktiviteteve të tjera vetëdijesuese për ambientin duhet ti njoftojë qytetarët edhe për të drejtat e tyre për një ambient të pastër dhe pasojat ligjore në rast të shkeljes së tij.





## Për EC

EC angazhohet për qëndrueshmëri ekonomike dhe qeverisje demokratike në nivel lokal (dhe rajonal) përmes mobilizimit të komunitetit, mbikqërjes së vendimmarrjes publike dhe partneritetit në zbatim të programeve dhe politikave zhvillimore.

Për përmbushjen e këtij misioni organizata zbaton projekte dhe nisma në kuadër të dy programeve kryesore: Qytete/Komuna Gjithëpërfshirëse dhe Zhvillim i Qëndrueshëm. Ndërsa programi i tretë është ideuar si njësi mbështetëse për veprimin e organizatës dhe synon adresimin e tri sfidave të jashtme dhe të brendshme: **1.** Vëllimin e pamjaftueshëm të dijes empirike në vend, përfshi të dhënat e besueshme statistikore, analizat e specializuara dhe mendimet profesionale, **2.** Nevojën për konsolidimin e kapaciteteve të brendshme, veçanërisht në hulumtime, baza të të dhënave, analizë, menaxhim, zhvillim komunitar dhe ekspertizë sektoriale, dhe **3.** Mungesën e qëndrueshmërisë financiare afatgjatë duke i diversifikuar burimet e të hyrave, me theks në ofrimin e shërbimeve për palët e treta.

Trekëndëshi konceptual që do të orientojë punën e organizatës në pesë vitet e ardhshme (2020 – 2024) ka këto elemente:

**1.** Gjithëpërfshirjen, **2.** Qëndrueshmërinë, dhe **3.** Dijen. EC beson se demokratizimi dhe zhvillimi i gjithëmbarshtëm shtetëror është proces që duhet planifikuar dhe ndërtuar nga posht lart. Në thelb të qeverisjes demokratike qëndron hapja dhe përfshirja e të gjithëve në marrjen e vendimeve që kanë për synim të mirën e përbashkët, ndërsa planifikimi zhvillimor kërkon shfrytëzim racional të burimeve territoriale, pa e kompromituar përdorshmërinë e tyre nga gjeneratat e ardhshme. Si demokracia ashtu edhe zhvillimi duhen ndërtuar mbi bazën e dijes së shëndoshë që garanton vendime dhe veprime të mençura dhe vizionare.

Vlerat kryesore të organizatës janë:

- 1.** Paanshmëria - EC vepron në bazë të analizave të thukta dhe gjithëpërfshirëse dhe mënjanon veprimet e ngutshme dhe impulsive. EC synon të përkrahë dhe të shtyjë përpara alternativat të cilat në bazë të hulumtimit dalin të jenë më të përshtatshmet, pavarësisht nëse masa e shoqërisë nuk e përkrahin këtë opsion;
- 2.** Aktivizmi - Anëtarët e EC do të jenë aktivistë të cilët angazhohen në baza të rregullta për të shtyer përpara bashkëveprimin qytetar për të përmbushur misionin e organizatës;
- 3.** Orientimi drejt rezultateve - Anëtarët e EC janë të orientuar për të arritur rezultate, ku përpjekja nuk i kënaq pritjet e organizatës në qoftë se nuk përfundon me rezultatet e pritura dhe
- 4.** Komuniteti bazë e veprimit - EC do të jetë gjithnjë pranë komunitetit, duke mësuar nga qytetarët dhe duke ndërtuar konsensus për bashkëveprimin dhe formësimin e shoqërisë.